# FLETORJA ZYRTARE

## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2025 – Numri: 140

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E premte, 1 gusht 2025**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 31.7.2025 | Për një ndryshim në vendimin nr. 91, datë 12.2.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2026–2028"........................................ | 19715 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 31.7.2025 | Për emërimin e një anëtari të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura........................................ | 19722 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 31.7.2025 | Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Bashkia Tiranë tek Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurisë me numër 7/74, në zonën kadastrale 8160, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar........................................ | 19722 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 31.7.2025 | Për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar........................................ | 19724 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 439, datë 31.7.2025 | Për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të disa pronave dhe për disa shtesa në vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës", të ndryshuar........................................ | 19728 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 31.7.2025 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i shkollës së mesme 'Ramiz Aranitasi', Çorovodë, si dhe ruajtjes së perimetrit të sigurisë në shkolla", Bashkia Skrapar.. | 19734 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 441, datë 31.7.2025 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës kthesa e Pashallisë–Konizbaltë deri në Konizbaltë", Bashkia Dimal.................................................................. | 19736 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 31.7.2025 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 329, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i linjës 110 kV Fibër – Elbasan'"......... | 19738 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 443, datë 31.7.2025 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor '*By-pass* Vlorë (shtesa)'", të ndryshuar..... | 19740 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 31.7.2025 | Për kalimin te Bashkia Krujë të njësive individuale të banimit............ | 19741 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 31.7.2025 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 428, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit" ......................................... | 19744 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 31.7.2025 | Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik e të zhvilluesit të zonës me vendndodhje në Kashar, Tiranë..................... | 19745 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 455, datë 31.7.2025 | Për miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2024... | 19747 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 31.7.2025 | Për përcaktimin e institucioneve përgjegjëse, të procedurave të miratimit dhe të dokumentacionit që duhet të plotësojnë familjet që përfitojnë kredi me interes të barabartë me 0%, të subvencionuar nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave............. | 19758 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 1.7.2025 | Për përcaktimin e organizatave sindikale dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës................................................................. | 19760 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 31.7.2025 | Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Ansambël Arkitektonik Urban" të një zone në qytetin e Konispolit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të tij dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre......................................... | 19761 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 31.7.2025 | Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit "Korpusi i inspektorateve" dhe projekteve të tjera të investimit........................... | 19769 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 31.7.2025 | Për një ndryshim në vendimin nr. 329, datë 18.4.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifës së biletave të Cirkut Kombëtar"......................................................................................... | 19772 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 461, datë 31.7.2025 | Për emërimin në detyrë të drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve | 19772 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 31.7.2025 | Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Reida Kashta........... | 19772 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 31.7.2025 | Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme.... | 19773 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 31.7.2025 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 16, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit për vitin 2025 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil"........ | 19774 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 31.7.2025 | Për shfuqizimin e vendimit nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës", të ndryshuar......................................... | 19774 |

**VENDIM**
**Nr. 435, datë 31.7.2025**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 91, DATË 12.2.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PRIORITARE 2026–2028"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 5, të vendimit nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aneksi 1, i përmendur në kreun V, "Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare", të Dokumentit të Politikave Prioritare 2026–2028, bashkëlidhur vendimit nr. 91, datë 12.2.2025, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me aneksin, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, si dhe të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore, që janë pjesë e procesit të buxhetimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**I. PROJEKTE INVESTIMI ME STATUS "I MATURUAR"**

| NR | EMËRTIMI | INSTITUCIONI PROPOZUES/PËRGJEGJËS | SEKTORI | NËNSEKTORI | VLERA INDIKATIVE | STATUSI I MATURITETIT | NIVELI I PRIORITETIT INSTITUCIONAL | OZHQ | COFOG |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | E-Qeverisja 2.0 | AKSHI | DIGJITAL | INFRASTRUKTURA E-GOV | € 66,000,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 01.3 |
| 2 | *Krijimi i Smart Labs – rrjeti i laboratorëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për sistemin arsimor parauniversitar | AKSHI | DIGJITAL | INFRASTRUKTURA E-GOV | € 40,666,000 | I MATURUAR | A | 4.2 | 09.7 |
| 3 | Digjitalizimi i Shërbimeve Vendore të Qeverisjes Lokale dhe Sistemi Elektronik i Prokurimit me Inteligjencë Artificiale | AKSHI | DIGJITAL | INFRASTRUKTURA E-GOV | € 76,900,000 | I MATURUAR | A | 17.6 | 04.6 |
| 4 | Përmirësimi i infrastrukturës së IT në burgje | AKSHI | DIGJITAL | INFRASTRUKTURA E-GOV | € 20,124,964 | I MATURUAR | B | 16.6 | 03.4 |
| 5 | **Zgjerimi i rrjetit GovNET (në të gjithë Shqipërinë) | AKSHI | DIGJITAL | INFRASTRUKTURA E-GOV | € 46,386,271 | I MATURUAR | B | 16.7 | 01.3 |
| 6 | Ngritja e Qendrës BCC dhe DRC për sistemet elektronike qeveritare | AKSHI | DIGJITAL | INFRASTRUKTURA E-GOV | € 43,000,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 01.3 |
| 7 | Krijimi i Hartës Bazë në Republikën e Shqipërisë | ASIG | ZHVILLIMI EKONOMIK | ZHVILLIMI RAJONAL | € 19,374,000 | I MATURUAR | A | 8.9 | 04.1 |
| 8 | Kampusi i Univeritetit të Tiranës | BT | SOCIAL | ARSIMI DHE SPORTET | € 166,050,983 | I MATURUAR | A | 4.3 | 09.6 |
| 9 | Nyjet Multimodale të Mobilitetit | FSHZH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 100,000,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 01.6 |
| 10 | Përmirësimi i rrjetit rrugor dytësor dhe lokal | FSHZH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 100,000,000 | I MATURUAR | A | 11.3 | 04.5 |
| 11 | Mbështetje për Zhvillimin e Qëndrueshëm Rajonal në zonat me potencial ekonomik në Shqipëri | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | TURIZMI | € 60,000,000 | I MATURUAR | A | 8.9 | 04.1 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Turizmi i integruar rajonal dhe studimi i përmirësimit urban për projektin e portës së Alpeve | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | TURIZMI | € 100,000,000 | I MATURUAR | A | 15.4 | 04.9 |
| 13 | Ngritja e infrastrukturës arsimore të Kolegjit të Evropës | MAS/FSHZH | SOCIAL | EDUKIMI DHE SPORTET | € 21,000,000 | I MATURUAR | A | 17.5 | 09.8 |
| 14 | Sistemi i Kamerave në administrim të Policisë Shtetit - Smart City | MB | SOCIAL | SIGURIA E BRENDSHME | € 112,472,051 | I MATURUAR | A | 16.6 | 03.5 |
| 15 | Identiteti Digjital për Shtetasit Shqiptarë | MB/IDENTITEK | DIGJITAL | NDËRLIDHJA ME BREZ TË GJERË | € 50,000,000 | I MATURUAR | A | 9.5 | 01.5 |
| 16 | Qëndrushmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë | MBZHR | ZHVILLIMI EKONOMIK | BUJQËSIA | € 64,600,000 | I MATURUAR | A | 2.3 | 04.2 |
| 17 | Ekonomia Blu | MBZHR | ZHVILLIMI EKONOMIK | BUJQËSIA | € 25,000,000 | I MATURUAR | A | 14.1 | 05.1 |
| 18 | Instituti i Rehabilitimit dhe Riintegrimit për të Miturit në Konflikt me Ligjin | MD | SOCIAL | DREJTËSIA | € 22,000,000 | I MATURUAR | A | 16.2 | 03.4 |
| 19 | Restaurimi, Rindërtimi dhe Muzealizimi i Projektimit të Muzeut Historik Kombëtar | MEKI | SOCIAL | KULTURA | € 26,112,036 | I MATURUAR | A | 11.4 | 08.2 |
| 20 | Zona Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Koplik | MEKI | ZHVILLIMI EKONOMIK | ZHVILLIMI I BIZNESIT | € 18,000,000 | I MATURUAR | B | 8.2 | 04.1 |
| 21 | Ngritja e Auto-Moto Park në Shqipëri | MEKI | ZHVILLIMI EKONOMIK | ZHVILLIMI RAJONAL | € 188,501,689 | I MATURUAR | A | 8.9 | 08.1 |
| 22 | Projekti i Portit të Integruar të Durrësit në Porto Romano | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI DETAR | € 390,000,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 23 | Zhvillimi i projektit ITS | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 100,000,000 | I MATURUAR | A | 9.2 | 04.5 |
| 24 | Masa mbështetëse për eficencën e energjisë me burime të rinovueshme | MIE | ENERGJIA | PRODHIMI I ENERGJISË | € 20,000,000 | I MATURUAR | A | 7.2 | 04.3 |
| 25 | Rehabilitimi i rrugës Fier-Kthesa e Patosit -Frataj | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 40,000,000 | I MATURUAR | A | 6.2 | 04.5 |
| 26 | Ndërtimi i bypass-it të Sarandës | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 34,000,000 | I MATURUAR | A | 6.2 | 04.5 |
| 27 | Ndërtimi i aksit rrugor Elbasan-Lekaj, Korridori VIII | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 360,000,000 | I MATURUAR | A | 6.2 | 04.5 |
| 28 | Programi infrastrukturor – përmirësimi i lidhjes rajonale | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 195,145,000 | I MATURUAR | C | 17.6 | 04.5 |
| 29 | ** Përmirësimi I ITUN Durrës dhe Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të përdorura në zonën historike të qytetit të Durrësit | MIE/AKUK | MJEDISI | FURNIZIMI ME UJË | € 119,800,000 | I MATURUAR | A | 14.1 | 05.2 |
| 30 | Programi kombëtar i modernizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri | MIE/AKUK | MJEDISI | FURNIZIMI ME UJË | € 141,300,000 | I MATURUAR | A | 6.4 | 06.3 |
| 31 | *Ndërtimi i bypass-it Tiranë | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 223,000,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 32 | Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Milot - Balldren | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 213,600,000 | I MATURUAR | A | 11.2 | 04.5 |
| 33 | Zgjerimi i autostradës Tiranë-Durrës | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 298,860,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 34 | Ndërtimi i rrugës Tiranë-Ndroq-Plepa | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 87,000,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 35 | Projekti për ndërtimin e urave rezistente | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 100,000,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 36 | Ndërtimi i bypass-it të Elbasanit | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 240,000,000 | I MATURUAR | A | 9.4 | 04.5 |
| 37 | *Transporti i Gjelbër në qytetin e Tiranës | MIE/BT | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 110,370,000 | I MATURUAR | A | 11.6 | 04.5 |
| 38 | *Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 122,900,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 39 | **Elektrifikimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe lidhja me Aeroportin e Rinasit | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 27,500,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 40 | Elektrifikimi i linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 59,910,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 41 | *Rehabilitimi i hekurudhës Vorë-Hani Hotit | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 308,060,000 | I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 42 | *Ndërtimi i Impiantit fotovoltaik 50 Mwp në Belsh | MIE/KESH | ENERGJIA | ENERGJIA E RINOVUESHME | € 40,000,000 | I MATURUAR | A | 7.2 | 04.3 |
| 43 | Rehabilitimi elektromekanik i HEC Vau i Dejës | MIE/KESH | ENERGJIA | PRODHIMI I ENERGJISË | € 110,500,000 | I MATURUAR | B | 7.1 | 04.3 |
| 44 | Instalimi i matësave të zgjuar dhe balancimi në pikat e transformimit, si dhe sistemi CRM/billing | MIE/OSHEE | ENERGJIA | EFICENCA E ENERGJISË | € 330,000,000 | I MATURUAR | A | 7.3 | 04.3 |
| 45 | Digjitalizimi i sistemit të transmetimit të Shqipërisë | MIE/OST | ENERGJIA | EFICENCA E ENERGJISË | € 51,500,000 | I MATURUAR | A | 7.1 | 04.3 |
| 46 | Programi i Efiçiencës së Energjisë në Sektorin e Transmetimit - ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës | MIE/OST | ENERGJIA | EFICENCA E ENERGJISË | € 49,173,745 | I MATURUAR | A | 7.1 | 04.3 |
| 47 | Mbështetje për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes civile | MM/AKMC | SOCIAL | MBROJTJA SOCIALE | € 30,000,000 | I MATURUAR | A | 16.1 | 03.5 |
| 48 | Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse "Deti Blu" | MTM | ZHVILLIMI EKONOMIK | TURIZMI | € 75,500,000 | I MATURUAR | A | 12.2 | 05.4 |

## II. PROJEKTE INVESTIMI ME STATUS "PJESËRISHT I MATURUAR"

| NR | EMËRTIMI | INSTITUCIONI PROPOZUES/PËRGJEGJËS | SEKTORI | NËNSEKTORI | VLERA INDIKATIVE | STATUSI I MATURITETIT | NIVELI I PRIORITETIT INSTITUCIONAL | OZHQ | COFOG |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 49 | Business Intelligence për Administratën Publike | AKSHI | DIGJITAL | PLATFORMAT E INOVACIONIT | € 24,379,618 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 9.1 | 01.5 |
| 50 | Krijimi i një qendre kompjuterike me performancë të lartë dhe krijimi i një rrjeti të sigurtë shkëmbimi informacioni për të mundësuar ndërveprimin rajonal në rajonin e Ballkanit Perëndimor | AKSHI | DIGJITAL | NDËRLIDHJA ME BREZ TË GJERË | € 15,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 17.6 | 04.6 |
| 51 | Programi "100 Fshatrat" | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | ZHVILLIMI RAJONAL | € 102,500,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 8.9 | 04.8 |
| 52 | Ndërtimi i qendrës së Biosimulimit të Universitetit Mjekësisë Tiranë | MAS | SOCIAL | SHËNDETËSIA | € 26,943,982 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 3.8 | 07.5 |
| 53 | Përgatitja dhe aftesitë ripërëritëse ndaj ndryshimeve klimatike (AL-PACT) | MB | MJEDISI | MENAXHIMI I FATKEQËSIVE | € 99,210,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 13.3 | 10.8 |
| 54 | **Përmirësimi i infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet në lumenjtë Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë | MBZHR | MJEDISI | MBROJTJA NGA PËRMBYTJET | € 105,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 3.1 | 04.2 |
| 55 | **Rehabilitimi i 431 digave në drejtim të rritjes së sigurisë së digave dhe disponueshmerise së ujit për ujitje | MBZHR | MJEDISI | MBROJTJA NGA PËRMBYTJET | € 171,500,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 15.3 | 04.2 |
| 56 | Amfiteatri i Durrësit | MEKI | SOCIAL | KULTURA | € 38,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 11.4 | 08.2 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 57 | Përmirësimi i infrastrukturës së turizmit dhe biznesit në zonën ndërkufitare në Korçë, Shqipëri | MF | ZHVILLIMI EKONOMIK | TURIZMI | € 26,520,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | C | 8.9 | 04.1 |
| 58 | **Gazsjellësi Adriatiko Jonian – Seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë | MIE | ENERGJIA | GAZI | € 172,500,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 17.9 | 04.3 |
| 59 | Segmenti Rrugor Milot-Reps | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 60,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 60 | Ndërtim rruga "Bushtricë-Pika Doganore, Korridori VIII" | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 176,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 61 | Porti i integruar i Durrësit-Faza 2 | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI DETAR | € 261,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 9.1 | 04.5 |
| 62 | Hekurudha Porto Romano-Sukth | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 29,500,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 63 | Aeroporti i Jugut | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 34,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.4 | 04.5 |
| 64 | Baza autonome detare Porto Romano | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI DETAR | € 366,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 65 | **Projekti për zhvillimin e infrastrukturës rajonale me brez të gjerë | MIE | DIGJITAL | NDËRLIDHJA ME BREZ TË GJERË | € 114,186,060 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 17.6 | 04.6 |
| 66 | Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe (Faza e II-të Kashar) | MIE | MJEDISI | FURNIZIMI ME UJË | € 130,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 6.4 | 06.3 |
| 67 | **Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të përdorura në zonën rezidenciale të qytetit të Durrësit (Porto Romano, Spitallë, Shkozet) | MIE/AKUK | MJEDISI | FURNIZIMI ME UJË | € 69,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 14.1 | 05.2 |
| 68 | **Gazsjellësi Fier-Vlorë që do të lidhë gazsjellësin TAP me TEC-in e Vlorës | MIE/ALBGAZ | ENERGJIA | GAZI | € 50,500,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 7.1 | 04.3 |
| 69 | **Magazinimi nëntokësor i gazit natyror në zonën e Dumresë (UGS Dumrea) | MIE/ALBGAZ | ENERGJIA | GAZI | € 89,500,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 12.2 | 04.3 |
| 70 | **Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Murriqan - Lezhë (Balldren) | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 469,410,202 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 71 | Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Gjirokastër-Kakavijë | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 138,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 72 | Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Pocem – Memaliaj | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 597,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 73 | Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Memaliaj – Ura e Subashit | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 260,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 74 | Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Fier Bypass (Levan)-Pocem | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 160,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 75 | Korridori Adriatiko Jonian - Bypass-i Gjirokastrës | MIE/ARRSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 100,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 76 | **Rehabilitimi i hekurudhës "Rrogozhinë-Pogradec/Prrenjas-Rrajcë-kufi me Maqedoninë e Veriut | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 451,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 9.1 | 04.5 |
| 77 | Ndërtimi i linjës hekurudhore Durrës – Prishtinë | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 750,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 9.1 | 04.5 |
| 78 | **Ndërtimi i një pompe depozituese "Pump Storage", Koman - Fierzë | MIE/KESH | ENERGJIA | EFICENCA E ENERGJISË | € 202,670,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 7.3 | 04.3 |
| 79 | HEC Skavica | MIE/KESH | ENERGJIA | TRANSMETIMI I ENERGJISË | € 800,050,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 7.1 | 04.3 |
| 80 | Rindërtimi i linjës 220 kV Vau i Dejës (Shqipëri) - Podgoricë (Mali i Zi) dhe zgjerimi në 400/220 kV i nënstacionit të Vaut të Dejës | MIE/OST | ENERGJIA | TRANSMETIMI I ENERGJISË | € 70,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | B | 7.3 | 04.3 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 81 | **Ndërtimi i një linje të re OHL 400 kV midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë dhe mbyllja e unazës së brendshme 400 kV | MIE/OST | ENERGJIA | TRANSMETIMI I ENERGJISË | € 53,600,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 17.9 | 04.3 |
| 82 | "Institucioni Mjekësor i Posaçëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, Lezhë." | MSHMS | SOCIAL | SHËNDETËSIA | € 20,000,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 16.6 | 10.1 |
| 83 | Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri - ALBAdapt | MTM | MJEDISI | ZHVILLIMI I QENDRUESHËM | € 37,700,000 | PJESËRISHT I MATURUAR | A | 13.1 | 05.6 |

**III. PROJEKTE INVESTIMI ME STATUS " I PAMATURUAR"**

| NR | EMËRTIMI | INSTITUCIONI PROPOZUES/PËRGJEGJËS | SEKTORI | NËNSEKTORI | VLERA INDIKATIVE | STATUSI I MATURITETIT | NIVELI I PRIORITETIT INSTITUCIONAL | OZHQ | COFOG |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 84 | Park shkencor dhe teknologjik "Technopark Tirana" | BT | ZHVILLIMI EKONOMIK | ZHVILLIMI I BIZNESIT | € 21,000,000 | I PAMATURUAR | C | 8.9 | 04.8 |
| 85 | Përmirësimi i infrastrukturës fizike për qendrat e dijes dhe rekreacionit komunitar | FSHZH | SOCIAL | ARSIMI DHE SPORTET | € 28,500,000 | I PAMATURUAR | C | 4.3 | 08.1 |
| 86 | Qendra multifunksionale e startupeve | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | SIPËRMARRJA | € 30,000,000 | I PAMATURUAR | C | 9.5 | 04.8 |
| 87 | Mbështetja për zhvillimin e "Economic Clusters" në nivel rajonal dhe lokal | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | ZHVILLIMI I BIZNESIT | € 55,000,000 | I PAMATURUAR | C | 17.7 | 04.1 |
| 88 | Përmirësimi i infrastrukturës së turizmit dhe biznesit të lidhur me të në zonën ndërkufitare në Alpet Shqiptare/Malet e Prokletijes | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | TURIZMI | € 30,000,000 | I PAMATURUAR | C | 8.9 | 04.1 |
| 89 | Masa efektive ndërkufitare për konkurrencën, rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal në zonën ndërkufitare Shqipëri-Kosovë | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | TURIZMI | € 54,000,000 | I PAMATURUAR | C | 8.9 | 04.1 |
| 90 | Zhvillimi i sipërmarrjes lokale dhe turizmit ndërkufitar përgjatë liqenit të Shkodrës/Skadarit përmes përmirësimeve në infrastrukturën e biznesit | FSHZH | ZHVILLIMI EKONOMIK | TURIZMI | € 25,000,000 | I PAMATURUAR | C | 8.9 | 04.1 |
| 91 | Ndërtimi I Qendrës Multifunksionale të Stërvitjes për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe struktura të tjera të Policisë së Shtetit | MB | SOCIAL | SIGURIA E BRENDSHME | € 15,000,000 | I PAMATURUAR | B | 16.6 | 03.5 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 92 | Rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes që shërben një sipërfaqe prej 75 000 ha me ngritje mekanike të ujit kryesisht në zonën bregdetare perëndimore | MBZHR | MJEDISI | MBROJTJA NGA PËRMBYTJET | € 115,000,000 | I PAMATURUAR | A | 14.1 | 04.2 |
| 93 | Mbështetje për Skemën Kombëtare dhe linjëzimin me EU-acquis në Sektorin Bujqësor dhe Rural | MBZHR | ZHVILLIMI EKONOMIK | AGRIKULTURA | € 50,000,000 | I PAMATURUAR | A | 8.1 | 04.2 |
| 94 | Ndërtimi i godinës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë | MD/KLGJ | SOCIAL | DREJTËSIA | € 15,000,000 | I PAMATURUAR | B | 16.3 | 03.3 |
| 95 | Ndërtimi i Prokurorive të Tiranës, Durrësit dhe Fier | MD/PP | SOCIAL | DREJTËSIA | € 15,000,000 | I PAMATURUAR | A | 16.3 | 03.3 |
| 96 | Ndërtimi i Arkivit Dixhital Kombëtar Kulturor | MEKI | DIGJITAL | PLATFORMAT E INOVACIONIT | € 18,800,000 | I PAMATURUAR | B | 16.1 | 08.2 |
| 97 | Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të perballueshëm për familjet me të ardhura te ulëta dhe te mesme | MEKI | SOCIAL | STREHIMI | € 15,500,000 | I PAMATURUAR | A | 16.1 | 10.6 |
| 98 | **Krijimi i qendrave të Ekselencës dhe Inovacionit në Nanoteknologji dhe Shkenca Biomarine | MEKI | ZHVILLIMI EKONOMIK | SIPËRMARRJA | € 31,000,000 | I PAMATURUAR | A | 9.5 | 09.7 |
| 99 | Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0 | MEKI | ZHVILLIMI EKONOMIK | SIPËRMARRJA | € 38,105,000 | I PAMATURUAR | A | 9.5 | 09.7 |
| 100 | Përmirësimi dhe vendosja e sistemeve të integruara të menaxhimit të informacionit në Dogana | MF | DIGJITAL | INFRASTRUKTURA E-GOV | € 30,000,000 | I PAMATURUAR | C | 16.6 | 01.6 |
| 101 | TEC Vlora | MIE/ALBGAZ | ENERGJIA | PRODHIMI I ENERGJISË | € 250,000,000 | I PAMATURUAR | A | 7.1 | 04.3 |
| 102 | Ndërtimi i rrjetit të transmetimit të gazit natyror në qytetin e Korcës | MIE | ENERGJIA | ENERGJIA E RINOVUESHME | € 17,000,000 | I PAMATURUAR | A | 7.2 | 04.3 |
| 103 | Linja e re e interkonjeksionit nënujor HVDC Vlorë (Shqipëri)- Brindisi (Itali) | MIE | ENERGJIA | TRANSMETIMI I ENERGJISË | € 310,000,000 | I PAMATURUAR | A | 19.9 | 04.3 |
| 104 | Digjitalizimi i Kaskadës së Drinit së bashku me rrjedhën e poshtme | MIE | ENERGJIA | EFICENCA E ENERGJISË | € 80,000,000 | I PAMATURUAR | A | 7.1 | 04.3 |
| 105 | Ndërtimi i një centrali të ruajtjes së energjisë elektrike | MIE | ENERGJIA | EFICENCA E ENERGJISË | € 120,000,000 | I PAMATURUAR | B | 7.3 | 04.3 |
| 106 | Ndërtimi i rrugës së karvanit - rruga e lashtë e karvanit, Vlorë-Berat-Voskopojë-Korçë | MIE | TRANSPORTI | TRANSPORTI RRUGOR | € 118,000,000 | I PAMATURUAR | C | 9.1 | 04.5 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 107 | Rindërtimi dhe zhvillimi i rrjetit naftësjellës shqiptar (nën administrimin e Albpetrol sh.a) | MIE | ENERGJIA | NAFTA | € 155,000,000 | I PAMATURUAR | C | 7.3 | 04.3 |
| 108 | Përmirësimi dixhital i sistemeve të integruara të energjisë brenda Ballkanit Perëndimor si shtytës kryesor për një epokë të re | MIE | ENERGJIA | TRANSMETIMI I ENERGJISË | € 50,000,000 | I PAMATURUAR | C | 17.6 | 04.3 |
| 109 | Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve, njësia Administrative Cërravë, Bashkia Pogradec | MIE/AKUK | MJEDISI | ZHVILLIMI I QENDRUESHËM | € 17,340,000 | I PAMATURUAR | A | 6.5 | 05.2 |
| 110 | Terminali LNG në Vlorë | MIE/ALBGAZ | ENERGJIA | GAZI | € 120,000,000 | I PAMATURUAR | B | 8.4 | 04.3 |
| 111 | **Gazsjellësi i Shqipërisë dhe Kosovës (ALKOGAP) | MIE/ALBGAZ | ENERGJIA | GAZI | € 195,500,000 | I PAMATURUAR | C | 7.3 | 04.3 |
| 112 | Rehabilitimi i Linjës hekurudhore Rrogozhinë - Vlorë dhe Lidhja e re me Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 220,000,000 | I PAMATURUAR | A | 9.1 | 01.5 |
| 113 | Ndërtimi i lidhjes së re hekurudhore Pogradec - Korcë - Kufiri me Greqinë | MIE/HSH | TRANSPORTI | TRANSPORTI HEKURUDHOR | € 250,000,000 | I PAMATURUAR | B | 9.1 | 04.5 |
| 114 | Park Fotovoltaik Belsh 250 Mwp | MIE/KESH | ENERGJIA | ENERGJIA E RINOVUESHME | € 150,000,000 | I PAMATURUAR | B | 7.3 | 04.3 |
| 115 | **Vlerësimi i potencialit të energjisë eolike në Shqipëri për ndërtimin e fermave të erës dhe Ndërtimi i një Centrali Eolik në det (off Shore) | MIE/KESH | ENERGJIA | ENERGJIA E RINOVUESHME | € 100,000,000 | I PAMATURUAR | B | 7.2 | 04.3 |
| 116 | Zgjerimi dhe spostimi i Nënstacionit ekzistues Tirana 1 me nivel tensioni 400 kV | MIE/OST | ENERGJIA | TRANSMETIMI I ENERGJISË | € 17,000,000 | I PAMATURUAR | B | 7.1 | 04.3 |
| 117 | **Digjitalizimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë në Shqipëri | MIE/OSHEE | ENERGJIA | EFICENCA E ENERGJISË | € 118,300,000 | I PAMATURUAR | A | 7.3 | 04.3 |
| 118 | Zgjerimi i Nënstacionit 400 KV të Fierzës dhe interkoneksion i ri 400 KV Shqiperi - Kosovë | MIE/OST | ENERGJIA | TRANSMETIMI I ENERGJISË | € 55,000,000 | I PAMATURUAR | A | 7.1 | 04.3 |
| 119 | Ndërtimi i 8 qendrave të rehabilitimit | MSHMS | SOCIAL | SHËNDETËSIA | € 21,850,000 | I PAMATURUAR | A | 16.6 | 07.4 |
| 120 | Qendrat e rehabilitimit shëndetësor dhe social, të quajtura "Shtëpi mbështetje" për personat me çrregullime të rënda mendore | MSHMS | SOCIAL | SHËNDETËSIA | € 16,500,000 | I PAMATURUAR | A | 3.4 | 10.1 |

** Projekti ka përfituar investim me mbështetje nga WBIF*

*** Projekti ka përfituar asistencë teknike me mbështetje nga WBIF*

## VENDIM
## Nr. 436, datë 31.7.2025

## PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 5, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Hermon Bonati emërohet anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për periudhën e mbetur të mandatit, sipas përcaktimit të shkronjës "d", të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 437, datë 31.7.2025

## PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA BASHKIA TIRANË TEK MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT, TË PASURISË ME NUMËR 7/74, NË ZONËN KADASTRALE 8160, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 834, DATË 13.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Bashkia Tiranë te Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurisë me numër 7/74, në zonën kadastrale 8160, Tiranë, sipas planit të rilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit "Rivitalizimi i Pallatit të Kongreseve".
2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i hiqet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës", të ndryshuar.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI:** BASHKIA TIRANE **DATE 29/07/2025** **QELLIMI:** NDRYSHIM PERGJ.ADMINISTRIMI

**VENDNDODHJA**
BASHKIA TIRANE DVASHK/ TIRANA JUG ZONA KADASTRALE 8160 NUMRI PASURISE 7/74 INDEX HARTE TR-S-12

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE Truall SIPERFAQE TOTALE E PASURISE 2261 m² SIPERFAQE TOTALE E NDERTIMIT m² NUMRI KATEVE NUMRI PEMEVE 0

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X: 485017.117
Y:4576120.529

X: 485213.451
Y:4576120.529




X: 485017.117
Y:4575995.736

**SH 1:1000**

X: 485213.451
Y:4575995.736

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Veri | | | Pas.7/88 | | Te dhena te mara nga harta kadastrale |
| 2. | Jug | | | Pas.7/3 | | Te dhena te mara nga harta kadastrale |
| 3. | Lindje | | | Pas.7/56 | | Te dhena te mara nga harta kadastrale |
| 4. | Perendim | | | Pas.7/89.7/73 | | Te dhena te mara nga harta kadastrale |

**REALIZOI**

Ing.

LICENCA NR.

KOMPANIA:

NIPT:

NENSHKRIMI / VULA

Erjona Teodori DATE (Digitally signed by Erjona Teodori Date: 2025.07.29)

**REALIZOJ PER ASHK**

SPECIALISTI ____________

DVASH ______

NENSHKRIMI / VULA

**KONFIRMOI**

PERGJEGJES/DREJTORI ____________

NENSHKRIMI / VULA

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE: O Z**
Kode për teknologjinë e matjeve: **T**-Terren; **Z**- Zyrë; **O**-Ortofoto; **G**-GPS; **S**-Stacion Total; **D**-Matje Distancash

**PERCAKTIMI I KUFIRIT: P ; HK**
Kode për përcaktimin e kufirit: **P**-Përfaqësuesi i Pronave; **K**-Kufitarët të gjithë; **KP**-Kufitarët Pjesërisht; **PB**-Përfaqësues të Bashkisë; **HK**-Harta Kadastrale

**SHENIME TE VEÇANTA:**

**PRONARI/BASHKPRONARET - DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFIRARET**

EMRI BASHKIA TIRANE

NENSHKRIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT SEKRETAR

Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimin e kufirit: **T**-Terren; **Z**- Zyrë; **O**-Ortofoto; **G**-GPS; **S**-Stacion Total; **D**-Matje Distancash; **P**-Përfaqësuesi i Pronave; **K**-Kufitarët të gjithë; **KP**-Kufitarët Pjesërisht; **PB**-Përfaqësues të Bashkisë; **HK**-Harta Kadastrale

**VENDIM**
**Nr. 438, datë 31.7.2025**

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, përmasat e pronave me numrat rendorë 580, me emërtimin "Ish-pularia, reparti ushtarak nr. 1015", dhe 1137, me emërtimin "Heliodromi i repartit ushtarak nr. 3340", zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët, gjithsej, 2 (dy) fletë inventari, dhe planrilevimet, gjithsej, 2 (dy), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS**

Institucioni Qendror Shtetëror
MINISTRIA E MBROJTJES

Identifikoi pronën: N/Kol Revis Xhepa/Shefi i Degës Logjistike i Forcës Tokësore
(Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)

Supervizor: Kolonel Ilirjan Dauti / Shefi i Shtabit i Forcës Tokësore
(Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)

Aprovoi: Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia / Komandant i Forcës Tokësore
(Emri, Mbiemri, Pozicioni Zyrtar)

| Nr. | Zona Kadastrale Indeksi i Hartës | Numri i pasurisë | Lloji i pasurisë | Emërtesa e Pasurisë Adresa | Sip. e pasurisë (m2) | Nga sip | | Funksioni që përdoret | Institucioni me përgjegjësi administrative / pronësi | Institucioni përdorues i pronës Statusi juridik i përdorimit | Inventarizuar me VKM | Të dhëna të tjera |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Truall (m2) | Ndërtesë (m2) | | | | | |
| 580 | 1903 K-34-114-87-D | 304/1, vol.8, fq.50 | Truall | "Ish Pularia, Reparti Ushtarak nr. 1015", Gurras, Pogradec | 16000 | 16000 | | Për mbrojtjen | Ministria e Mbrojtjes / Komanda e Forcës Tokësore (Reparti Ushtarak Nr. 1001) | Regjimenti i Operacioneve Speciale (Reparti Ushtarak Nr.1040) | VKM Nr. 515 datë 18.07.2003, i ndryshuar me VKM Nr. 10, datë 11.01.2016 | |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.1 | | | 1099.34 | | | | | 2-Katësh |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.2 | | | 1169.1 | | | | | 2-Katësh |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.3 | | | 298.9 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.4 | | | 564 | | | | | 2-Katësh |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.5 | | | 92.24 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.6 | | | 585.6 | | | | | 2-Katësh |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.7 | | | 569.7 | | | | | 2-Katësh |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.8 | | | 115.15 | | | | | |
| 580 | 1903 K-34-114-87-D | 304/1, vol.8, fq.50 | Ndërtesë | Objekti Nr.9 | | | 150.8 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.10 | | | 151.69 | | | | | 2-Katësh |
| | | | Ndërtesë | Objekti Nr.11 | | | 28 | | | | | |
| | | | | Total | 16000 | 16000 | 4824.52 | | | | | |

1.FORMULARI I PËRDITËSIMIT T TË PRONËS NR.1137 "Heliodromi I Repartit Ushtarak nr. 3340" FARKE, TIRANE

Bashkia Tiranë

Identifikoi pronën :
N/Kol Miri **Jera** Specialist Infrastrukture
N/Kol Olgert **Koroveshi** Shefi I Zbulimit
Civil Sadik **Ismaili** Keshilltar Ligjor

Supervizoi:
N/Kol Pellumb **Sevdari** Shefi i Logjistikes
N/Kol Sajmir **Germenji** Shefi i Zyres Komandantit
N/Kol Shpetim **Hysa** Oficer Shtabi per sistemet UAV dhe GBAD
N/Kol Selvie **Iljazi** Shef i Finances

Aprovoi:
Komandanti i Repartit Ushtarak Nr. 3001
Gjeneralmajor Ferdinant **DIMO**

| Nr | Zona Kadastrale & Indeksi I Hartes | Nr. I Pasurisë | Lloji I Pasurisë | Emertesa e Pasurisë , Adresa | Sip e pasurisë (m2) | Nga Sip | | Funksioni për të cilin përdoret prona /pronari | Institucioni me përgjegjesi administrastive / pronësi | Institucioni perdorues I pasurisë , statusi juridik I perdorimit | Inventarizuar me VKM | Të dhëna të tjera (Shënime të Veçanta |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Truall (m2) | Ndërtesa (M2) | | | | | |
| 1137 | ZK 1604, | | | Heliodromi I Repartit Ushtarak Nr. 3340 | | | | Per mbrojtjen | MM/Komanda e Forces Ajrore | Komanda e Forces Ajrore/Baza Ajrore Farke | VKM nr. 737, date 16.02.2012 | |
| | ZK 1604, K-34-100-(29-A,13-C) | 867/7 | Truall | Objekti Nr. 1 me emertim "Kulle vrojtimi" | 44509.95 | 44509.95 | 145.87 | | | | | |
| | | | | Objekti Nr. 2 me emërtim "Ish truproja" | | | 12.28 | | | | | |
| Totali | | | | | 44509.95 | 44509.95 | 158.15 | | | | | |

# PLAN RILEVIMI
## i Pronës nr.580 "Ish Pularia Rep. Usht. nr.1015" Gurras, Pogradec

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM, (FT) DATË 02/04/2025 QËLLIMI Përditësim

VENDNDODHJA
Bashkia Pogradec ZVASHK Pogradec Nr.Pasurisë 304/1 ZK 1903 Indeksi i Hartës K-34-114-(87-D)

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë TRUALL Sip e pasurisë **16000m²** Sip e gjurmës së ndërtimit **5047.42m²** Nr. kateve Nr. pemeve____

Nord =4527536.66
East = 559442.31

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord =4527536.66
East = 559882.22




Nord =4527185.59
East = 559442.31

SH 1: 2500
METRA

Nord =4527185.59
East = 559882.22

| NR ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 Veri | | | | K51726024H | |
| 2 Lindje | | | | | |
| 3 Jug | | | | | |
| 4 Perëndim | | | | | |

REALIZOI PËR IGJIU
Ing. Eris Ndrukaj

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI
MsC. ARK. Jurgen **ÇOLAKU**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti____________
DVASHK____________
Nënshkrimi____________
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori____________
Nënshkrimi/ Vula____________

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto; Azhornimit në terren.
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas **Hartës Kadastrale** dhe faktit.
Shënime : Ky Planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës të Komandës të FT-s nr.110/2, datë 17.01.2025 bazuar në dokumentacionin teknik arkivor, ortofoton e vitit 2015 marrë në geoportalin e ASIG-ut dhe azhornimit të kryer në terren në b/punim me përfaqsuesin e FT. Kufiri i pronës është hedhur sipas HTR b/lidhur shkresës.

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Tokësore)
MIRATOHET
KOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE
Gjeneralmajor Ilir **XHEBEXHIA**

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

Prona nr.1137 "Heliodromi" Farkë, Tiranë

PRONARI :REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Ajrore) DATË 25/06/2025 QËLLIMI PËRDITËSIM

VENDNDODHJA

Bashkia TIRANË ZVASHK TIRANË Nr.Pasurisë 867/7 Z.K1604 Indeksi i Hartës K-34-100-(13-C,29-A)

TE DHËNAT E PASURISË

Lloi i pasurisë Truall Sip e pasurisë **46949 m²** Sip e gjurmës së ndërtimit **118.77 m²** Nr. kateve 1 Nr. pemeve____

Nord = 4575386.71
East = 489760.38

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4575386.71
East = 490200.29




Nord = 4575035.64
East = 489760.38

SH 1: 2500

METRA

Nord = 4575035.64
East = 490200.29

| NR ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 Veri | | | | K51726024H | |
| 2 Lindje | | | | | |
| 3 Jug | | | | | |
| 4 Perëndim | | | | | |

REALIZOI PËR IGJIU
Major Arjana Saliko

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI
MsC.Ark. Jurgen **ÇOLAKU**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti____________
DVASHK____________
Nënshkrimi____________
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori____________
Nënshkrimi/ Vula____________

TEKNOLOGJIA E MATJEVE GPS R8; O-Ortofoto;

PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas matjeve në terren dhe të dokumentacionit hartografik marrë në arkivin e IGJIU.

SHËNIME TË VEÇANTA:Ky plan rilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Komandës së Forcës Ajrore nr.1144, datë 04.03.2025, bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, ortofoton e vitit 2015 marrë në geoportalin e ASIG-ut, matjeve të kryera në terren, hedhur mbi HTR.

PRONARI:REPUBLIKA E SHQIPËRISË,MM(FORCA AJRORE)

MIRATOHET
KOMANDANT I FORCËS AJRORE
Gjeneralmajor Ferdinant **DIMO**

**VENDIM**
**Nr. 439, datë 31.7.2025**

## PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR TË DISA PRONAVE DHE PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 421, DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pronave, me numrat rendorë 856–859, sipas shtojcës nr. 1, formularëve, planeve të rilevimit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Pronat sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur vendimit, i shtohen lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës", të ndryshuar.

3. Në vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, pika 1, paragrafi i dytë, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Lista me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 859 (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë).".

4. Bashkisë Shkodër i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurive, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t'i tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Bashkia Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

SHTOJCA NR. 1
BASHKIA SHKODËR

| Numri rendor i pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronave | Lloji i transferimit të pronave |
|---|---|---|
| 856, 857 | Për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 858, 859 | Në ushtrimin e funksioneve administrative | Në pronësi |

# 1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror Shtetëror /Bashkia:Shkodër

Identifikoi pronën: Arjan VASIJA Arban GJOKA Specialist
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi:
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi::Alban PREKA Zv.Kryetar me vendim delegimi
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| Nr. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Pasurisë | Emërtesa e pasurisë Adresa | Sip. e pasurisë (m2) | Nga Sip. Truall (m2) | Nga Sip. Ndërtesë (m2) | Funksioni për të cilin përdoret prona/ pasuria | Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi | Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit | Inventarizuar me VKM | Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 568 | 2665 K-34-64-163-C | 33/6 | Shesh Truall | Zyrat e NJA Postribe Bashkia Shkoder | 1410 | 1410 | 317 | Administrate | Bashkia Shkoder | Bashkia Shkoder | Me Urdher te MPVD Nr 35/12,dt 15.11.2002 | Ndertese 1 kat |
| 569 | 2665 K-34-64-163-C | 33/7 | Truall | Zyrat e NJA Postribe Bashkia Shkoder | 1489 | 120 | 57 | Administrate | Bashkia Shkoder | Bashkia Shkoder | Me Urdher te MPVD Nr 35/12,dt 15.11.2002 | |
a) Për centralet deri në 2 *mw*, tarifa fikse në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

b) Për centralet mbi 2 *mw* deri në 10 *mw*, tarifa fikse në vlerën 3 000 000 (tre milionë) lekë;

c) Për centralet mbi 10 *mw* deri në 50 *mw*, tarifa fikse në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

ç) Për centralet mbi 50 *mw* deri në 100 *mw*, tarifa fikse në vlerën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë;

d) Për centralet mbi 100 *mw*, tarifa fikse në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.

4/2. Pagesa e tarifës për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe tarifa për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit, sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij kreu, kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së zhvillimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.".

4. Pikat 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"5. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi është në vlerën 1% të vlerës së investimit të deklaruar në sistemin e-Leje. Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit, të hartuar dhe të deklaruar nga inxhinieri preventivues, sipas legjislacionit në fuqi. Preventivi i investimit dhe deklarata e inxhinierit preventivues, me anë të së cilës deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë civile dhe penale se preventivi është hartuar në përputhje me rregullat dhe manualet në fuqi, ngarkohen nga kërkuesi në sistemin e-Leje. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës së arkëtimit nga AZHT-ja.

6. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për ndryshimin e subjektit zhvillues është në vlerën 1% të vlerës së investimit të deklaruar në sistemin e-Leje. Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit, të hartuar dhe të deklaruar nga inxhinieri preventivues, sipas legjislacionit në fuqi. Preventivi i investimit dhe deklarata e inxhinierit preventivues, me anë të së cilës deklaron nën përgjegjësinë e tij të plotë civile dhe penale se preventivi është hartuar në përputhje me rregullat dhe manualet në fuqi,

ngarkohen nga kërkuesi në sistemin e-Leje. Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.”.

5. Në pikën 8, fjalët “..., si dhe për lëshimin e certifikatave të përdorimit ...” dhe fjalia e fundit hiqen.

6. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e certifikatave të përdorimit është në vlerën 1% e diferencës midis vlerës së situacionit përfundimtar të punimeve me preventivin fillestar të investimit, të deklaruar në sistemin e-Leje në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit. Pagesa për lëshimin e certifikatave të përdorimit kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja.”.

7. Në pikën 11, pas fjalëve “... apo të objekteve publike ...” shtohen “... si dhe objektet me destinacion publik që ndërtohen në bazë të partneriteteve publike private ...”.

II. Dispozitë kalimtare

Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, merr të gjitha masat, që, brenda muajit mars 2026, të kryhet lëshimi i faturave brenda sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit. Deri në krijimin e modaliteteve përkatëse, brenda sistemit e-Leje, AZHT-ja mund të kryejë lëshimin e faturave dhe autorizimeve për kryerjen e pagesave, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim, jashtë sistemit e-Leje.

III. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 453, datë 31.7.2025

## PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK E TË ZHVILLUESIT TË ZONËS ME VENDNDODHJE NË KASHAR, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 52 140 (pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet) $m^2$, pjesë të zonave kadastrale 2105, 2119, me vendndodhje në Kashar, Tiranë, me emërtimin “*Teda Nexus Park Tirana*”, të përbërë nga pasuritë me sipërfaqet përkatëse, sipas listës dhe genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” përcaktohen në genplanin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë që do të zhvillohen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” janë të llojit:

a) industri automotive, e automobilave, e mjeteve motorike të ujit, tokës dhe ajrit;

b) industri e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT);

c) industri e pajisjeve elektronike, inxhinierike, kimike, minerare, ndërtimi, mekanike dhe elektrike;

ç) industri farmaceutike, dentare dhe shëndetësore;

d) industri të tjera prodhuese, përpunuese të pjesshme apo të plota;

dh) industri agropërpunuese dhe agroprodhuese;

e) shërbime distribucioni dhe logjistike;

ë) përpunim dhe magazinim mallrash;

f) tregtar dhe eksport-import;

g) industri të tjera, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 (tridhjetë e pesë) vjet me të drejtë përsëritjeje deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

5. Zhvillues i "Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik" shpallet bashkimi i shoqërive "*Astral*" sh.p.k. dhe "*Capital Resources*" sh.p.k.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Shtetërore Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË "*TEDA NEXUS PARK TIRANA*", KASHAR, TIRANË

| **ZK** | **Numri i pasurisë** | **Sipërfaqja totale e pasurisë (m²)** | **Pronësia** |
|---|---|---|---|
| 2105 | 1156/47 | 9484 | "ASTRAL" sh.p.k. |
| 2105 | 1156/17 | 1600 | "ASTRAL" sh.p.k. |
| 2119 | 156/4/12+0 | 500 | "ASTRAL" sh.p.k. |
| 2119 | 156/16 | 19831 | "ASTRAL" sh.p.k. (kontratë sipërmarrjeje nr. 118 rep., nr. 73 kol., datë 13.4.2022 ). |
| 2119 | 156/14 | 15300 | "ASTRAL" sh.p.k. (kontratë sipërmarrjeje nr. 118 rep., nr. 73 kol., datë 13.4.2022). |
| 2105 | 1156/1 | 5425 | "ASTRAL" sh.p.k. (kontratë sipërmarrjeje nr. 118 rep., nr. 73 kol., datë 13.4.2022). |
| | | **52,140** | |

**GENPLANI I "ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK"**



**VENDIM**
**Nr. 455, datë 31.7.2025**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**RAPORTI VJETOR**
PËR NDIHMAT SHTETËRORE
TË VITIT 2024

**Përmbledhje**

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5 të MSA-së dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) mbështetur në vendimet e Komisionit të Ndihmës Shtetërore për autorizimin e ndihmës shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga zbatuesit e skemave të ndihmës shtetërore të miratuara sipas vendime të miratuara nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, si: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Bashkia e Tiranës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Raporti 2024 përfshin të dhëna për periudhën 2014–2024, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport me ndihmën shtetërore, të dhënë në vendet e BE-së.

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesorë që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2020–2024. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2020–2024 është vlerësuar në rreth 57.854,7 milionë lekë ( 501.8 milionë €), prej të cilave 7.815,15 milionë lekë (79.5 milionë €) që përfaqësojnë 0.45 % të PBB-së, janë dhënë në vitin 2024. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2024, vendin kryesor (rreth 40.93 %) e zënë ndihma sektoriale, ndërsa ndihmat horizontale përbën 40.93 % të ndihmës gjithsej. Pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin *"de minimis"* të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2024 janë grantet, përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore dhe garancia shtetërore.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, Raporti Vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2024 do t'i përcillet Komisionit Evropian.

**Përmbajtja**

PËRMBLEDHJE
I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETË-RORE
1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore
II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2024
2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2020–2024
2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore
2.2.1 Ndihma shtetërore horizontale
2.2.2 Ndihma shtetërore sektoriale
III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

**- Baza ligjore**

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore, si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

**- Përkufizimi i ndihmës shtetërore**

Në bazë të nenit 4, pika 1 ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcaktohet se:

*"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".*

Gjithashtu neni 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[1], përcakton se:

*"Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."*

**- Përfitues i ndihmës shtetërore**

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarra nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar dhe të nenit 107(1) të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kritereve të mëposhtme:

- Masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore,
- Masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar, *si edhe*
- Masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis Shteteve Anëtare.

**Çfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?**

*a) Ndihma për organet publike dhe njësive të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet jo ekonomik;*

*b) Masa të përgjithshme të destinuara për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme etj.;*

*c) Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve me çmimin e tregut;*

1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

- Ndihma shtetërore horizontale përfshin:
- Ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;
- Ndihmën për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme;
- Ndihmën për punësim;
- Ndihmën për trajnim;
- Ndihmën operacionale;
- Ndihmën për sportin;
- Ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- Ndihmën për transportin publik;
- Ndihmën për shërbimin publik;
- Ndihmën për infrastrukturën *broadband.*

Ndihmën për turizmin.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente, si:

A1. Subvencione dhe grante;

A2. Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore;

A3. Garancitë shtetërore.

II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2024

[1] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare'.

2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2020–2024

**A. Ndihma shtetërore krahasuar me treguesit kryesore socio-ekonomike**

*Tabela nr. 1. Ndihma shtetërore krahasuar me disa me tregues socio-ekonomike 2020–2024*

| Treguesit | Njësia e matjes | 2021 | Shkalla e ndihmës 2021 | 2022 | Shkalla e ndihmës 2022 | 2023 | Shkalla e ndihmës 2023 | 2024 | Shkalla e ndihmës 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PBB | mld lekë | 1,856.2 | 0.25 | 2,138.3 | 0.289 | 2,311.7 | 0.371 | 2,494.2 | 0.31 |
| Të punësuar (15-64 vjec) | nr | 1,198,177 | 3,822 | 1,262,335 | 4,899 | 1,243,085 | 6,891 | 1,243,085 | 6,287 |
| Popullsia | nr | 2,829,741 | 1,618 | 2,793,592 | 2,214 | 2,761,785 | 3,101 | 2,761,785 | 2,830 |
| Ndihma shtetërore | mln lekë | 4,579.18 | | 6,184.69 | | 8,565.5 | | 7,815.2 | |

*Burimi: MF dhe MEKI*

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri në periudhën 2020–2024 si edhe treguesit e përqindjes së ndihmës shtetërore ndaj PBB-së; ndihmë shtetërore për person të punësuar dhe ndihma shtetërore për person të popullsisë. Ndihma shtetërore gjithsej në vitin 2024 është dhënë në vlerën totale 7.815,15 mln lekë (79.5 mln euro). Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u ul nga 0.37 % në 2023, në 0.31 % në vitin 2024.

Grafiku nr. 1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për periudhën 2014–2024.

*Grafiku nr. 1. Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2014–2023*




*Burimi: MF dhe MEKI*

**B. Shkalla e ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe shtetet e Bashkimit Evropian**

Tabela nr. 2, paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për periudhën 2022–2023.

*Tabela nr. 2. Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për periudhën 2022–2023*

| Periudha / Shtetet | 2022 | 2023 |
|---|---|---|
| Shqipëri | 0.289 | 0.371 |
| Austri | 0.099 | 0.042 |
| Belgjike | 0.074 | 0.068 |
| Bullgari | 0.011 | 0.006 |
| Qipro | 0.002 | 0.002 |
| Ceki | 0.056 | 0.043 |
| Gjermani | 0.945 | 0.588 |
| Danimarke | 0.066 | 0.059 |
| Estoni | 0.004 | 0.004 |
| Greqi | 0.034 | 0.032 |
| Spanje | 0.204 | 0.144 |
| Finlande | 0.033 | 0.035 |
| France | 0.526 | 0.424 |
| Kroaci | 0.007 | 0.017 |
| Hungari | 0.044 | 0.067 |
| Irlande | 0.022 | 0.023 |
| Itali | 0.342 | 0.251 |
| Lituani | 0.009 | 0.009 |
| Luksemburg | 0.006 | 0.006 |
| Letoni | 0.005 | 0.004 |
| Malte | 0.003 | 0.004 |
| Hollande | 0.106 | 0.068 |
| Poloni | 0.078 | 0.131 |
| Portugali | 0.030 | 0.017 |
| Rumani | 0.053 | 0.039 |
| Suedi | 0.063 | 0.067 |
| Slloveni | 0.006 | 0.011 |
| Sllovaki | 0.012 | 0.011 |

***Burimi**: Komisioni Evropian, DG Competition*[2]*, MEKI (%)*

**2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore**

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndihmë shtetërore horizontale; *dhe*
- Ndihmë shtetërore sektoriale.

**Ndihma shtetërore horizontale** jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.

**Ndihma shtetërore sektoriale** jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

[2] https://competition-policy.ec.europa.eu/state-aid/scoreboard_en

*Tabela nr. 3. Ndihma shtetërore gjithsej 2020–2024 ndarë sipas kategorive (në milion lekë)*

| KATEGORIA | 2020 | | | 2021 | | | 2022 | | | 2023 | | | 2024 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *mln lekë* | *mln euro* | *në %* | *mln lekë* | *mln euro* | *në %* | *mln lekë* | *mln euro* | *në %* | *mln lekë* | *mln euro* | *në %* | *mln lekë* | *mln euro* | *në %* |
| **Ndihma Horizontale** | **28,815.79** | **232.84** | **93.83%** | **2,511.09** | **20.29** | **54.84%** | **3,244.26** | **28.23** | **52.46%** | **5,274.29** | **51.32** | **61.58%** | **3,198.67** | **32.54** | **40.93%** |
| *Punësimi* | 0.51 | 0.004 | 0.0% | 44.40 | 0.36 | 1.0% | 23.01 | 0.20 | 0.4% | 65.73 | 0.64 | 0.8% | 49.92 | 0.51 | 0.6% |
| *Trajnim* | 3.50 | 0.03 | 0.0% | 67.36 | 0.54 | 1.5% | 21.04 | 0.18 | 0.3% | 28.76 | 0.28 | 0.3% | 19.74 | 0.20 | 0.3% |
| *Sport* | 125.31 | 1.01 | 0.4% | 185.90 | 1.50 | 4.1% | 587.70 | 5.11 | 9.5% | 915.87 | 8.91 | 10.7% | 842.55 | 8.57 | 10.8% |
| *Kultura* | 93.99 | 0.76 | 0.3% | 84.04 | 0.68 | 1.8% | 84.04 | 0.73 | 1.4% | 156.55 | 1.52 | 1.8% | 243.36 | 2.48 | 3.1% |
| *Ndihma operacionale* | 27,475.35 | 222.01 | 89.5% | 325.30 | 2.63 | 7.1% | 233.91 | 2.04 | 3.8% | 233.15 | 2.27 | 2.7% | 1,017.47 | 10.35 | 13.0% |
| *Kerkim, zhvillim dhe inovacion* | 1,096.00 | 8.86 | 3.6% | 1,768.02 | 14.29 | 38.6% | 1,985.79 | 17.28 | 32.1% | 3,864.73 | 37.60 | 45.1% | 533.29 | 5.43 | 6.8% |
| *SME* | 21.13 | 0.17 | 0.1% | 36.08 | 0.29 | 0.8% | 308.77 | 2.69 | 5.0% | 9.50 | 0.09 | 0.1% | 492.34 | 5.01 | 6.3% |
| **Ndihma Sektoriale** | **1,894.90** | **15.31** | **6.17%** | **2,068.09** | **16.71** | **45.16%** | **2,939.98** | **25.58** | **47.54%** | **3,291.21** | **32.02** | **38.42%** | **4,616.48** | **46.96** | **59.07%** |
| *Transport publik (Hekurudha)* | 400.00 | 3.23 | 1.3% | 400.00 | 3.23 | 8.7% | 501.00 | 4.36 | 8.1% | 490.00 | 4.77 | 5.7% | 500.00 | 5.09 | 6.4% |
| *Shërbimi publik* | 720.00 | 5.82 | 2.3% | 380.00 | 3.07 | 8.3% | 360.00 | 3.13 | 5.8% | 310.00 | 3.02 | 3.6% | 350.00 | 3.56 | 4.5% |
| *Infrastruktura Broadband* | 30.90 | 0.25 | 0.1% | 17.53 | 0.14 | 0.4% | 3.16 | 0.03 | 0.1% | - | - | 0.0% | - | - | |
| *Turizmi* | 744.00 | 6.01 | 2.4% | 1,270.56 | 10.27 | 27.7% | 2,075.82 | 18.06 | 33.6% | 2,491.21 | 24.24 | 29.1% | 3,766.48 | 38.32 | 48.2% |
| **TOTALI** | **30,710.69** | **248.15** | **100** | **4,579.18** | **37.00** | **100** | **6,184.24** | **53.81** | **100** | **8,565.50** | **83.34** | **100** | **7,815.15** | **79.50** | **100** |

***Burimi:*** *MEKI*

*Grafiku nr. 2. Ndihma shtetërore gjithsej 2020–2024*




***Burimi:*** *MEKI*

*Grafiku nr. 3. Ndihma shtetërore horizontale/sektoriale 2020–2024*




***Burimi:*** *MEKI*

Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 3, tregojnë se në vitin 2024, ndihma shtetërore horizontale zë pjesën më të vogël të ndihmës shtetërore gjithsej me 40.93 %, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 59.07 %.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2024 u ulën me 750.35 mln lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2023. Në grafikun nr. 4 paraqiten të dhënat për peshën e ndihmës shtetërore për çdo kategori të ndihmës në raport me ndihmën gjithsej.

*Grafiku nr. 4. Shpërndarja e kategorive të ndihmës shtetërore*




***Burimi:*** *MEKI*

### 2.2.1 Ndihma shtetërore horizontale

Në vitin 2024, ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 3.198,67 mln lekë (32.54 mln euro). Peshën kryesore për këtë kategori të ndihmës e zë ndihma për kërkim dhe zhvillim me 40.93 %.

*Tabela nr. 4. Ndihma shtetërore horizontale 2020–2024*

| Ndihma Horizontale | 2020 | | 2021 | | 2022 | | 2023 | | 2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* |
| *Punësimi* | 0.51 | 0.00 | 44.40 | 0.36 | 23.01 | 0.20 | 65.73 | 0.64 | 49.92 | 0.51 |
| *Trajnim* | 3.50 | 0.03 | 67.36 | 0.54 | 21.04 | 0.18 | 28.76 | 0.28 | 19.74 | 0.20 |
| *Sport* | 125.31 | 1.01 | 185.90 | 1.50 | 587.70 | 5.11 | 915.87 | 8.91 | 842.55 | 8.57 |
| *Kultura* | 93.99 | 0.76 | 84.04 | 0.68 | 84.04 | 0.73 | 156.55 | 1.52 | 243.36 | 2.48 |
| *Ndihma operacionale* | 27,475.35 | 222.01 | 325.30 | 2.63 | 233.91 | 2.04 | 233.15 | 2.27 | 1,017.47 | 10.35 |
| *Kerkim, zhvillim dhe inovacion* | 1,096.00 | 8.86 | 1,768.02 | 14.29 | 1,985.79 | 17.28 | 3,864.73 | 37.60 | 533.39 | 39.33 |
| *SME* | 21.13 | 0.17 | 36.08 | 0.29 | 308.77 | 2.69 | 9.50 | 0.09 | 492.34 | 5.01 |
| **TOTALI** | **28,815.79** | **232.84** | **2,511.09** | **20.29** | **3,244.26** | **28.23** | **5,274.29** | **51.32** | **3,198.77** | **66.44** |

***Burimi:*** *MEKI*

*Grafiku nr. 5. Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2020–2024*




***Burimi:*** *MEKI*

*Grafiku nr. 6: Struktura e ndihmës shtetërore horizontale më 2024-n*




***Burimi:*** *MEKI*

Në mënyrë më të detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore horizontale janë si vijon:

*Ndihma për punësim*: ndihma për punësim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale'". Në bazë të VKM-së nr. 17, datë 15.1.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", i ndryshuar, dhe VKM nr. 348, datë 29.4.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit skema ka pasur impaktin si vijon:

**- Programi i punësimit:** në këtë program u planifikuan 10.050.538 lekë dhe u realizuan fakt 9.710.264 lekë ose 97 % e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 36 subjekte, të cilët kanë punësuar 39 **punëkërkues të papunë**.

**- Programi i vetëpunësimit:** në këtë program u planifikuan 41.388.000 lekë dhe u realizuan fakt 40.214.696 lekë ose 98 % e fondit të planifikuar.

Numri i përfituesve të vetëpunësuar në program është 90.

*Ndihma për trajnim:* ndihma për trajnim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020 "Autorizim i ndihmës shtetërore "Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale".

**- Programi i formimit nëpërmjet punës:** Për këtë program u planifikuan 7.638.448 lekë dhe u realizuan fakt 5.435.666 lekë ose 71 % e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 14 subjekte, të cilët kanë punësuar 32 punëkërkues të papunë.

**- Programi i praktikave profesionale:** për këtë program u planifikuan 15.407.271 lekë dhe u realizuan fakt 14.306.058 lekë ose 93 % e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 41 subjekte, të cilët kanë punësuar 168 punëkërkues të papunë.

*Ndihma për sportin:* Ndihma për sportin është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 54, datë 26.1.2015, "Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit". Për këtë skemë ndihme, objektivi kryesor i të cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike, duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2024 janë dhënë 842.55 mln lekë.

*Ndihma për nxitjen e kulturës*: Ndihma për kulturën është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 56, datë 4.6.2015, "Autorizim i ndihmës shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore". Në vitin 2024, ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është në vlerën 243.36 mln lekë në formën e mbështetjes financiare me fonde publike për mbështetjen e prodhimit, distribuimit dhe promovimit të filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentare dhe të animuar, si dhe projekteve të ndryshme kinematografike dhe festivaleve kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit (34 projekte nga 52 aplikime për *filma artistikë me metrazh të shkurtër 5, postproduksion 2, filma dokumentar 6, filma të animuar 1, promovimi i kinematografisë shqiptare 4, filma me metrazh të gjatë koproduksione në pakicë 6, filmi me metrazh të gjatë 2, festivale filmi 8*) dhe mbështetje për projektet e artit dhe kulturës.

*Ndihma operacionale*: Në këtë kategori përfshihen të dhëna të ndihmës shtetërore të autorizuara me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 24, datë 2.5.2008, "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit". Për vitin 2024 dhënësit dhe zbatuesit e ndihmës shtetërore raportojnë ndihmën shtetërore në shumën 77.22 mln lekë, nëpërmjet skemës së rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale me përfitues 7 subjekte. Me ligjin nr. 114/2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, është përcaktuar që afati i rimbursimit për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, është deri më datë 31 dhjetor 2023. Për këtë arsye, nga data 1 janar 2024, është hequr rimbursimi dhe këto subjekte kanë përfituar rimbursim për aplikimet e bëra që i përkasin vitit 2023.

*Ndihma për kërkim:* Ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë "marrëveshje hidrokarburesh" dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2024, sipas të dhënave të administratës tatimore, rezulton se shitjet e përjashtuara nga TVSH-ja për këto subjekte për vitin 2024 janë në vlerën 2,666,469,011 lekë. *Importimi i mallrave dhe i shërbimeve, që lidhen me realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione është i përjashtuar nga TVSH-ja.* Nëse do të zbatohej 20 % TVSH për këto shitje, ndihma do të ishte në vlerën 533.29 mln lekë, e konsideruar si efekti fiskal i krijuar nga kjo incentivë fiskale.

*Ndihma për SME:* Në vitin 2024 janë zbatuar skemat si vijon:

1. Vendim i KNSH-së nr. 119, datë 27.6.2024, "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Mbështetje financiare për biznese me fokus ripërdorimin'", të

zbatuar nga Bashkia Tiranë. Skema ka si objektiv mbështetjen financiare për biznese me fokus ripërdorimin me një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar sfidat urgjente që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe praktikat e konsumit të qëndrueshëm. Objektivat specifikë të skemës së ndihmës janë:

- Të ofrojë mbështetje për biznese të ndryshme që kryejnë veprimtari ekonomike në territorin e administruar nga Bashkia Tiranë si dhe të promovojë adaptimin e praktikave të ripërdorimit të produkteve;
- Të sigurojë financimin për fazat e para për sipërmarrësit dhe qëndrueshmërinë e biznesit të tyre;

Për vitin 2024 janë shpenzuar 9.71 mln lekë me 17 përfitues.

2. Vendim i KNSH-së nr. 109, datë 26.10.2022, "Për një ndryshim në vendimin e komisionit të ndihmës shtetërore nr. 103, datë 19.7.2021 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes"'. Skema ka si objektiv mbështetjen e grave me një ide të qartë për aktivitetin e tyre, për fillimin ose zgjerimin e një biznesi të vogël ose shumë të vogël dhe në territorin e Bashkisë së Tiranës. Për vitin 2024 janë shpenzuar 9.5 mln lekë me 20 përfitues.

3. Vendim i KNSH-së nr. 110, datë 1.12.2022, "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Për ndërmarrjet sociale"'. Skema synon mbështetjen për integrimin në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të formave të mbështetjes të ndërmarrjeve sociale. Për vitin 2024 janë akorduar 1.63 mln lekë.

4. Vendim nr. 120, datë 10.7.2024 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024"'. Akordimi i granteve synon mbështetjen e projekteve që nxisin rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e biznesit kreativ si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit. Për vitin 2024 janë akorduar 149.37 mln lekë dhe 101 përfitues.

5. Vendim i KNSH-së nr. 114, datë 11.12.2023 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Bizneset ekoinovative"'. Skema synon promovimin e një modeli të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe sherbimeve të NMV-ve një vlerë të shtuar në treg, si edhe ndërtimi i kapaciteteve të të rinjve me aftësitë e nevojshme për një ekonomi të gjelbër në Bashkinë e Shkodrës. Për vitin 2024 janë akorduar 4.58 mln lekë dhe 6 përfitues.

6. Vendim i KNSH-së nr. 113, datë 11.12.2023, "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 99, datë 16.10.2020 'Autorizim i ndihmës shtetërore 'Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja "të gjelbra"", të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese "të gjelbra" duke futur elemente *go-green* në to", i ndryshuar". Plani i ndihmës ka si objektiv mbështetjen e sipërmarrjeve të rinj që aspirojnë të krijojnë biznese të gjelbra dhe ndërmarrjet ekzistuese që aplikojnë parimet e ekonomisë së gjelbër në prodhimin produktesh dhe konsum lëndësh të para. Për vitin 2024 janë akorduar 15.5 mln lekë dhe 32 përfitues.

7. Vendim i KNSH-së 122, datë 27.11.2024, "Autorizim i ndihmës shtetërore "Grante për *start up*-et dhe lehtësuesit e start up-eve për vitin 2025". Granti në total i miratuar në vitin 2024 ka qenë 300.000.000 lekë, prej të cilave janë disbursuar 285.304.832 lekë me një numër prej 94 fituesish, prej të cilëve, 89 kanë qenë përfitues (*19 në fazën 1- fazë konceptuale, 52 në fazën 2 - fazë validimi dhe 18 në fazën 3- fazë shkallëzimi*).

**2.2.2 Ndihma shtetërore sektoriale**

Në vitin 2024, ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 4,616.48 mln lekë (46.96 mln euro). Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2024 është 41.41 %.

*Tabela nr. 5. Ndihma shtetërore sektoriale 2020–2024*

| **Ndihma sektoriale** | **2020** | | **2021** | | **2022** | | **2023** | | **2024** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* | *mln LEK* | *mln EUR* |
| *Transport publik (Hekurudha)* | 400.00 | 3.23 | 400.00 | 3.23 | 501.00 | 4.36 | 490.00 | 4.77 | 500.00 | 5.09 |
| *Shërbimi publik* | 720.00 | 5.82 | 380.00 | 3.07 | 360.00 | 3.13 | 310.00 | 3.02 | 350.00 | 3.56 |
| *Infrastruktura Broadband* | 30.90 | 0.25 | 17.53 | 0.14 | 3.16 | 0.61 | - | - | - | - |
| *Turizmi* | 744.00 | 6.01 | 1,270.56 | 10.27 | 2,075.82 | 18.06 | 2,491.21 | 24.24 | 3,766.48 | 38.32 |
| **TOTALI** | **1,894.90** | **15.31** | **2,068.09** | **16.71** | **2,939.98** | **26.16** | **3,291.21** | **32.02** | **4,616.48** | **46.96** |

***Burimi:*** *MEKI*

*Grafiku nr. 7. Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2020–2024*




***Burimi:*** *MEKI*

*Grafiku nr. 8: Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2024*




***Burimi:*** *MEKI*

Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2024, peshën kryesore e zë ndihma për turizmin (38.32 %).

*Ndihma për transportin publik* e dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor është 500 milionë lekë edhe në vitin 2024.

*Ndihma për shërbimet publike*: në vitin 2024, ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizime në shumën 350 mln lekë.

*Ndihma për turizmin:* në bazë të vendimit të KNSH-së nr. 82, datë 17.5.2018 "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Për skemën e incentivave fiskale në sektorin e turizmit'", ndihma për sektorin e turizmit nga buxheti i shtetit për vitin 2024 është përfituar nga strukturat akomoduse nga reduktimi i TVSH-se nga 20 % në 6% për vitin 2024 në shumën 3.624,42 mln lekë për 865 subjekte përfituese. Në bazë të vendimit të KNSH-së nr. 74, datë 12.12.2016 "Autorizim i ndihmës shtetërore nëpërmjet mbështetjes financiare të projekteve në sektorin e turizmit" në vitin 2024 janë dhënë 142.06 mln lekë me 38 përfitues.

III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2024, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-ja, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

*A1 – Subvencione dhe grante;*
*A2 – Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;*
*A 3 – Garancia shtetërore*
*B – Pjesëmarrja në kapital;*
*C1 – Hua të buta;*
*C2 – Instrumente të tjera;*
*D – Garancitë.*

*Tabela nr. 6. Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve*

| Ndihma Shtetërore | Subvencione dhe Grante (A1) | Përjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2) | Garanci Shtetërore (A 3) |
|---|---|---|---|
| ***Ndihma Horizontale*** | | | |
| *Punësimi* | 49.92 | | |
| *Trajnim* | 19.74 | | |
| *Sport* | 842.55 | | |
| *Kultura* | 243.361 | | |
| *Ndihma operacionale* | | 77.22 | 940.25 |
| *Kerkim, zhvillim dhe inovacion* | | 533.29 | |
| *SME* | 492.34 | | |
| ***Ndihma Sektoriale*** | | | |
| *Transport publik (Hekurudha)* | 500.00 | | |
| *Shërbimi publik* | 350.00 | | |
| *Infrastruktura Broadband* | - | | |
| *Turizmi* | 142.06 | 3624.42 | |
| **TOTALI** | **2,639.97** | **4,234.93** | **940.25** |

***Burimi:*** *MEKI*

Instrumenti i përdor më shumë është A2 – Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet social (54 %), A1 – Subvencione dhe grante (34 %) dhe A 3 – garancia shtetërore (12 %) sikurse paraqitet në grafikun nr. 9.

*Grafiku nr. 9. Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2024*




***Burimi:*** *MEKI*

**VENDIM**
**Nr. 456, datë 31.7.2025**

**PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE, TË PROCEDURAVE TË MIRATIMIT DHE TË DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJNË FAMILJET QË PËRFITOJNË KREDI ME INTERES TË BARABARTË ME 0%, TË SUBVENCIONUAR NGA BUXHETI I SHTETIT, NËPËRMJET ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 47/1, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse, të procedurave të miratimit dhe të dokumentacionit që duhet të plotësojnë:

a) familjet që banojnë si qiramarrës në ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara", të miratuar me ligjin nr. 82/2012;

b) familjet e punonjësve të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë;

c) fëmijët në përkujdesje të Republikës.

2. Masa e subvencionit të interesave të kredisë për familjet e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, për banesa me kosto të ulët, është me 0 (zero) % interes.

3. Aplikimi për përfitimin e kredisë me interes 0% kryhet nga kryefamiljari/kujdestari ligjor në portalin qeveritar "*e-Albania*", në sistemin e Entit Kombëtar të Banesave, duke ngarkuar vërtetimin negativ nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nuk figuron, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pronë e regjistruar ose në proces regjistrimi ose vërtetimin për një pronë që është nën normat e banimit.

3/1. Familjet qiramarrëse në ish-pronë private, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, ngarkojnë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) autorizimin ose dokumentin e lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i lagjes/Këshilli Popullor i lagjes, nëse disponon;

b) certifikatën apo vërtetimin e pronësisë në favor të pronarit ose vendimin e gjykatës, në të cilin vërtetohet se prona i është kthyer pronarit të ligjshëm dhe qytetari është i pastrehë;

c) vërtetimin negativ nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës përkatëse, që, në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes, sipas certifikatës së gjendjes familjare, të datës 1.12.1992, nuk figuron banesë e regjistruar ose në proces regjistrimi;

ç) vërtetimin nga organet tatimore se asnjë anëtar i familjes, që përfiton kredi të lehtësuar, nuk është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, si biznes i madh;

d) certifikatën e gjendjes familjare të datës 1 dhjetor 1992.

3/2. Me kërkesë të Entit Kombëtar të Banesave, Ministria e Brendshme i përcjell EKB-së dokumentacionin që vërteton statusin e familjes aplikuese si familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë.

3/3. Për fëmijët në përkujdesje të Republikës, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, kërkuesit ngarkojnë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Certifikatën personale të fëmijës me fotografi të tre muajve të fundit ose fotokopje të dokumentit të identifikimit;

b) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të familjarit, kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të fëmijës;

c) Prokurën e posaçme, në rastin kur kërkuesi është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i fëmijës.

4. Individët/familjet e miratuara për të përfituar kredi me interes 0 (zero) % qëndrojnë në listë pritjeje pa afat kohor të caktuar.

5. Lista e familjeve, që plotësojnë kushtet për të përfituar kredi me interes 0 (zero) %, miratohet me vendim të komisionit *ad-hoc* të kredisë, të ngritur pranë EKB-së. Komisioni *ad-hoc* ngrihet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Entit Kombëtar të Banesave, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesave. Komisioni shqyrton kërkesën brenda 10 (dhjetë) ditëve nga ngritja e tij. Ndaj vendimit të refuzimit të komisionit, kërkuesit paraqesin ankim administrativ pranë EKB-së brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

6. Listat e përfituesve përfshijnë të dhëna për përbërjen e familjes, sipas certifikatës familjare, strukturën e apartamentit që përfiton, si edhe të dhëna mbi gjendjen:

a) e strehimit;

b) familjare;

c) sociale.

7. Procedura e dhënies së subvencionimit të interesave të kredisë zbatohet nga institucionet financiare me të cilat ministria përgjegjëse për strehimin ka lidhur marrëveshje. Në rastet kur kryefamiljari, emri i të cilit i është përcjellë institucionit financiar, në rastin e familjeve qiramarrëse në ish-pronë private, ka ndërruar jetë, institucioni financiar vijon me procedurat e përfitimit të kredisë, duke pasur parasysh certifikatën familjare të datës 1 dhjetor 1992, të vënë në dispozicion nga EKB-ja.

8. Listat e familjeve përfituese të programit të subvencionimit të interesave të kredisë me 0 interes i dërgohen institucionit financiar me të cilin është nënshkruar marrëveshja, si dhe çdo institucioni që do të monitorojë subvencionimin.

9. Enti Kombëtar i Banesave, në rolin e institucionit që zbaton programin, njofton institucionin financiar për ndërprerjen e subvencionimit të interesave të kredisë kur, nga verifikimet konstatohen:

a) se qytetari nuk ka liruar banesën e pronarit brenda afatit të përcaktuar;

b) falsifikime të dokumenteve apo deklarata të rreme;

c) mangësi apo të meta në dokumentacionin e dosjes së familjes përfituese.

10. Shkronjat "b" dhe "c", të pikës 18, pika 26/1, shkronjat "a", "b", dhe "c", të pikës 28/1, dhe shkronja "a", e pikës 36, të vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti me përzgjedhjen e institucionit financiar që do të kreditojë familjet", të ndryshuar, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Enti Kombëtar i Banesave, ministria përgjegjëse për strehimin, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe institucionet financiare me të cilat janë nënshkruar marrëveshje për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 457, datë 1.7.2025**

## PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZATAVE SINDIKALE DHE TË PUNËDHËNËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat e punëdhënësve dhe organizatat sindikale, anëtare të Këshillit Kombëtar të Punës, janë, si më poshtë vijon:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

a) Bashkimi i Bizneseve Shqiptare (BIZNES ALBANIA): 1 anëtar, 1 kandidat;

b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB): 1 anëtar, 1 kandidat;

c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT): 1 anëtar, 1 kandidat;

d) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS): 1 anëtar, 1 kandidat;

dh) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Shoqata "Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë" (SHBPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

f) Shoqata *Proexport Albania* (SHPA): 1 anëtar, 1 kandidat;

g) Shoqata e Bukës, Pastiçerisë dhe Brumërave (SHBPB): 1 anëtar, 1 kandidat.

B. Për organizatat sindikale:

a) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

b) Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Ndërtimit dhe Shërbimeve Publike të Shqipërisë (SPPNSHPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

d) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

dh) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shëndetësisë së Shqipërisë (FSPSHSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

e) Federata e Sindikatave të Administratës Publike dhe Shërbimit Civil të Shqipërisë (FSAPSHCSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë (FSPTTSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

f) Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar (SPPTSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

g) Sindikata Autonome e Ushqimit, Agrikulturës, Tregtisë dhe Turizmit të Shqipërisë (SAUATT): 1 anëtar, 1 kandidat.

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri përgjegjës për punën, sipas propozimeve të organizatave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 356, datë 26.5.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 458, datë 31.7.2025**

**PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME "ANSAMBËL ARKITEKTONIK URBAN" TË NJË ZONE NË QYTETIN E KONISPOLIT, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE TË TIJ DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "a" e "ç", të pikës 3, të nenit 9, të nënndarjes "ii", të shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 53, të pikës 3, të nenit 62, dhe të pikës 1, të nenit 96, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Ansambël arkitektonik urban" të një zone në qytetin e Konispolit, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone në qytetin e Konispolit, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartave të "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone të qytetit të Konispolit dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.
5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën", dhe me aktet nënligjore në fuqi.
6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkia Konispol për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E "ANSAMBLIT ARKITEKTONIK URBAN", DHE ZONA MBROJTËSE TË NJË ZONE NË QYTETIN E KONISPOLIT**

Neni 1
**Qëllimi**

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të një zone në qytetin e Konispolit, si dhe kufijtë e tyre.

Neni 2
**Objekti**

Objekt i këtij plani është:
1. administrimi i "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të një zone të qytetit të Konispolit, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij plani, si pjesë integrale e tij.
2. mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave arkitektoniko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone të qytetit të Konispolit.
3. mënyra e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e të peizazhit të "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone të qytetit të Konispolit dhe zonës mbrojtëse të tij.

Neni 3
**Hapësira urbane në mbrojtje**

1. Hapësira urbane në mbrojtje të një zone të qytetit të Konispolit përbëhet nga:
a) ansambli arkitektonik urban;
b) zona mbrojtëse.
2. Brenda këtyre zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen pasuri kulturore, objekte shoqërore, banesa tradicionale të lidhura

ngushtë me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, historik, tradicional, zona të gjelbra, sheshe dhe rrjeti rrugor me prezencë kalldrëmi.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Konispol merr parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të tij.

4. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse përreth tij.

Neni 4

**"Ansambli arkitektonik urban" dhe kufijtë e tij**

1. "Ansambli arkitektonik urban" i një zone të qytetit të Konispolit është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit arkitektonik të qytetit dhe arritjet në arkitekturë e urbanistikë.

2. Kufijtë e "Ansamblit arkitektonik urban" paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar-KRGJSH paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5

**Zona mbrojtëse e "Ansambli arkitektonik urban" dhe kufijtë e tij**

1. Zona mbrojtëse ruan vlera arkitektoniko-kulturore dhe të peizazhit, me të cilat plotëson dhe pasuron vlerat e ansambli arkitektonik urban e krijon një kalim gradual prej saj drejt pjesëve të lira të qytetit.

2. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar-KRGJSH paraqiten në aneksin 2, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

**Ndërhyrjet e lejuara në "Ansamblin arkitektonik urban"**

1. Ndërhyrjet në "Ansamblin arkitektonik urban" kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, arkitektonike, urbanistike të një zone të qytetit të Konispolit.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të "Ansamblit arkitektonik urban", brenda kësaj zone lejohen këto ndërhyrje:

a) ndërhyrje sistematike mirëmbajtëse, konservuese, restauruese dhe rijetëzuese, sipas parimeve të konservimit të integruar;

b) ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistike-arkitekturore, rrjetit rrugor, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale;

c) rikonstruksioni/rindërtimi duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve, duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre (2–3 kate) 10.5 (dhjetë pikë pesë) m deri në kornizën e çatisë. Këto ndërhyrje shoqërohen me studime arkitektoniko-urbanistike për evidentimin e vlerave të trashëgimisë kulturore brenda zonës;

ç) çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbulohen me tjegulla vendi, ngjyrë të kuqe. Mbulesat e tjera, si soleta, llamarina, pllaka të ndryshme, si dhe tjegulla me ngjyrë tjetër janë të ndaluara;

d) në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni/rindërtimi mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

dh) ndërtimet e reja u nënshtrohen kritereve të përcaktuara në këtë plan. Leja e ndërtimit jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e zhvillimin e territorit dhe legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 7

**Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban"**

1. Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse janë:

a) ndërhyrje sistematike restauruese, konservuese e të mirëmbajtjes, përshtatje, rikonstruksione dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të

jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të zonës;

b) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

2. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, përveç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet t'i kalojë 3-4 katet dhe lartësinë 12.5 m deri në kornizën e çatisë.

3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

4. Çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25-30 gradë dhe të mbulohen me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe. Mbulesat e tjera, si llamarina, pllaka të ndryshme, si dhe tjegulla me ngjyrë tjetër janë të ndaluara.

5. Rrjeti rrugor ruhet në kompozimin, teknikën dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

6. Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale.

7. Ndërhyrje të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve, në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale.

8. Ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës, brenda së cilës rruga ndodhet. Në rastet kur gjurma e rrugës, në të cilën ndërhyhet, shtrihet në disa zona, ndërhyrja i nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë.

Neni 8

**Ndërhyrjet e lejuara në monumentet e kulturës**

1. Ndërhyrjet në monumentet e kulturës, të cilat ndodhen brenda "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone të qytetit të Konispolit, kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave, për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Ndërhyrjet e lejuara janë:

a) ndërhyrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 9

**Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të tij**

1. Në hapësirën e ansamblit arkitektonik urban nuk lejohen:

a) instalime që paraqesin rreziqe ose janë të një natyre të rrezikshme, që mund t'u shkaktojnë dëme të rënda ose të pandreqshme për njerëzit, pasuritë kulturore, natyrën dhe peizazhin;

b) depo të të gjitha llojeve;

c) terrene kampingu (për rulo);

ç) terrene sportive (me sipërfaqe mbi 200 $m^2$);

d) struktura industriale;

dh) gurore.

2. Në hapësirën e zonës mbrojtëse të ansamblit arkitektonik urban nuk lejohen:

a) depo të të gjitha llojeve;

b) struktura industriale;

c) guroret.

3. Ndërtimet pa leje, të ndodhura brenda territorit të "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone të qytetit të Konispolit dhe zonës mbrojtëse të tij, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoriteteve

të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuara shprehimisht në ligj".

Neni 10

**Objektet pa status, pjesë e ansamblit arkitektonik urban**

Objektet pa status, pjesë e "Ansamblit arkitektonik urban", janë objekte të ndërtuara deri në miratimin e këtij plani, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të tij.

Neni 11

**Kriteret e projektimit për ndërhyrjet e lejuara në "Ansamblin arkitektonik urban" dhe në zonën mbrojtëse të tij**

1. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e objekteve ekzistuese, brenda "Ansamblin arkitektonik urban" dhe në zonën mbrojtëse të tij, hartohen në varësi të vlerave historike-kulturore të objektit apo monumentit, për të cilët janë shpallur pasuri kulturore, bazuar në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe aktet nënligjore të tij, si dhe në kartat ndërkombëtare të restaurimit.

2. Projektet për rikonstruksionin/ rindërtimin/ ritrajtimin/ rijetëzimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja, brenda "Ansamblit arkitektonik urban", hartohen, bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme e të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik;

b) duke respektuar kushtet zhvillimore e vëllimore, trajtimin dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë, duke respektuar elemente të veçanta, me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke respektuar kushtin, që lartësia nuk duhet të kalojë lartësinë e dy–tri kateve, ose 10.5 m deri në kornizën e çatisë;

d) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dyerve dhe dritareve, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

dh) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çative katër ujëse, me pjerrësi 25–30 gradë, mbuluar me tjegulla vendi të kuqe, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.

3. Projektet për rikonstruksione dhe ndërtime të reja brenda zonës mbrojtëse duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të zonës dhe të respektojnë kriteret e mëposhtme:

a) lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, përveç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet t'i kalojë 3–4 katet dhe lartësinë 12.5 m deri në kornizën e çatisë;

b) kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.;

c) çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbulohen me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe. Mbulesat e tjera, si llamarina, pllaka të ndryshme dhe tjegulla me ngjyrë tjetër janë të ndaluara.

4. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, brenda zonës mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban", hartohen:

a) bazuar parashikimeve të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Konispol;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese në mbrojtje;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 12

**Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në "Ansamblin arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse**

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike, të cilat hartohen për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të "Ansamblit arkitektonik urban" dhe të cilat përcaktojnë objektet, ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, ritrajtime, rikonstruksione, rindërtime dhe rehabilitimi, hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim "IKTK"), Drejtoria Rajonale

e Trashëgimisë Kulturore (në vijim "DRTK"), përgjegjëse për Konispolin ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim "KKTKM").

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e rijetëzimin në "Ansamblit arkitektonik urban" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për Konispolin ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Konispolin ose nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/ rindërtimin/ ritrajtimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja brenda "Ansamblit arkitektonik urban" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për Konispolin ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja ose nga subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionet, ndërhyrje integruese, përshtatjet në sheshe të lira dhe ndërtimet e reja në zonën mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban" hartohen nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh, bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Konispol apo në studimet urbanistike e arkitektonike. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit dhe i ndërtimeve të reja kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK-ja përgjegjëse për Konispolin.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen sipas ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit. DRTK-ja përgjegjëse për Konispolin monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

6. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimin e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në "Ansamblin arkitektonik urban" hartohen nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Konispolin.

Neni 13
**Dispozita të fundit**

Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.


ANSAMBLI ARKITEKTONIK URBAN
ZONA MBROJTESE


ANSAMBLI ARKITEKTONIK URBAN
ZONA MBROJTESE

KOORDINATAT ZONA E MBROJTUR E ANSAMBLIT URBAN

| E | N |
|---|---|
| 515794.7247 | 4391711.607 |
| 515778.1372 | 4391730.167 |
| 515773.3813 | 4391730.012 |
| 515760.0417 | 4391762.414 |
| 515744.1115 | 4391751.897 |
| 515744.6528 | 4391745.014 |
| 515733.9038 | 4391736.972 |
| 515722.9228 | 4391738.054 |
| 515708.2299 | 4391734.188 |
| 515705.678 | 4391739.369 |
| 515663.5325 | 4391737.706 |
| 515652.6288 | 4391733.067 |
| 515646.4423 | 4391728.04 |
| 515640.7972 | 4391720.848 |
| 515639.3279 | 4391712.419 |
| 515621.6964 | 4391715.126 |
| 515617.5205 | 4391703.217 |
| 515606.1528 | 4391692.158 |
| 515617.8298 | 4391686.977 |
| 515610.2514 | 4391679.785 |
| 515614.1179 | 4391664.861 |
| 515622.315 | 4391645.218 |
| 515626.4136 | 4391635.088 |
| 515613.8086 | 4391634.237 |
| 515609.4781 | 4391617.611 |
| 515599.193 | 4391614.325 |
| 515578.3909 | 4391596.732 |
| 515552.5624 | 4391583.044 |
| 515552.0984 | 4391587.065 |
| 515526.6564 | 4391578.791 |
| 515531.2963 | 4391570.285 |
| 515498.0439 | 4391560.541 |
| 515497.8893 | 4391568.893 |
| 515494.8733 | 4391573.996 |
| 515478.2472 | 4391573.842 |
| 515453.4239 | 4391560.618 |
| 515448.6293 | 4391556.288 |
| 515425.2754 | 4391544.147 |
| 515408.8812 | 4391531.851 |
| 515404.396 | 4391532.779 |
| 515391.4043 | 4391548.168 |
| 515364.0291 | 4391524.659 |
| 515357.0693 | 4391508.497 |
| 515310.8253 | 4391512.982 |
| 515303.4789 | 4391531.619 |
| 515286.5433 | 4391535.486 |
| 515274.1704 | 4391541.672 |
| 515235.5821 | 4391529.222 |
| 515224.6785 | 4391541.904 |
| 515168.2654 | 4391520.406 |
| 515127.2413 | 4391517.777 |
| 515127.1253 | 4391474.974 |
| 515098.7447 | 4391475.438 |
| 515099.1314 | 4391468.092 |
| 515100.7554 | 4391467.396 |

| | |
|---|---|
| 515100.9873 | 4391455.641 |
| 515107.0192 | 4391443.578 |
| 515110.6151 | 4391430.509 |
| 515110.3831 | 4391414.965 |
| 515144.4088 | 4391412.104 |
| 515148.198 | 4391417.053 |
| 515191.1168 | 4391414.81 |
| 515245.4032 | 4391420.997 |
| 515252.5177 | 4391438.628 |
| 515287.4713 | 4391442.804 |
| 515307.2681 | 4391422.389 |
| 515324.8996 | 4391417.904 |
| 515355.368 | 4391415.429 |
| 515388.4657 | 4391412.336 |
| 515393.8789 | 4391418.058 |
| 515390.3217 | 4391463.993 |
| 515490.8521 | 4391492.915 |
| 515496.188 | 4391471.494 |
| 515495.492 | 4391454.945 |
| 515521.5526 | 4391452.471 |
| 515523.1765 | 4391462.292 |
| 515529.0537 | 4391461.518 |
| 515536.0908 | 4391485.568 |
| 515547.3038 | 4391482.862 |
| 515553.9543 | 4391476.907 |
| 515557.2022 | 4391479.305 |
| 515567.8353 | 4391474.007 |
| 515572.1658 | 4391483.287 |
| 515577.0377 | 4391489.01 |
| 515583.4561 | 4391486.767 |
| 515592.6585 | 4391503.857 |
| 515574.0991 | 4391515.225 |
| 515583.5335 | 4391529.454 |
| 515565.3607 | 4391551.338 |
| 515628.6175 | 4391581.343 |
| 515651.5075 | 4391584.668 |
| 515687.2731 | 4391616.799 |
| 515695.3929 | 4391614.866 |
| 515716.9296 | 4391637.408 |
| 515726.4414 | 4391657.243 |
| 515733.2078 | 4391672.942 |
| 515737.8477 | 4391679.592 |
| 515761.4337 | 4391697.688 |
| 515769.2441 | 4391698.384 |
| 515774.7346 | 4391694.981 |
| 515794.7247 | 4391711.607 |

**VENDIM**
**Nr. 459, datë 31.7.2025**

**PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT "KORPUSI I INSPEKTORATEVE" DHE PROJEKTEVE TË TJERA TË INVESTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe në vijim të shkronjës "b", të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare", me NIPT: M01917011D të pronave shtetërore, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për realizimin e projektit të investimit "Korpusi i inspektorateve" dhe projekteve të tjera të investimit.

2. Autorizimin e shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare", vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave, të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, sipas këtij vendimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i cili ka si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

3. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucioneve publike përfituese, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, përmbushjen e interesit të Korporatës, si dhe entiteteve në pronësi të të cilit/ave regjistrohet prona e re shtetërore.

4. Në funksion të realizimit të projektit të investimit "Korpusi i inspektorateve" dhe projekteve të tjera të investimit dhe në zbatim të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, ngarkohet Korporata e Investimeve Shqiptare të kryejë procesin e konsolidimit të pronave, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në rast se konstatohet mospërputhje midis gjendjes faktike dhe ligjore të pronës.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, për zhvillimin e pronave, të parashikuara në shtojcën nr. 1, nëpërmjet instrumentit të sipërmarrjes, me qëllim realizimin e projekteve të saj të investimit. Shpenzimet për shërbimet e parashikuara në këtë pikë mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare.

6. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, që në të njëjtën procedurë, të asistojë Korporatën e Investimeve Shqiptare nëpërmjet hartimit të termave të referencës për projektidetë arkitekturore, hartimin e kritereve të kualifikimit për projektuesit dhe kritereve të vlerësimit paraprak e përfundimtar të projektideve arkitekturore.

7. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negociimin me subjekte private, me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projekteve të saj të investimit.

8. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore

të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit, si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë/Korporatës, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit me institucionet publike përfituese, të pronës së re shtetërore, që do të krijohet në kuadër të projekteve të investimit.

9. Institucionet publike, të cilat zhvillojnë aktivitet në godinat e ngritura në pronat e përcaktuara në këtë vendim, do të vazhdojnë të përdorin pronën në funksion të aktivitetit të tyre deri në momentin e marrjes në dorëzim të ambienteve të reja, të ndërtuara në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjet, sipas pikës 3, të këtij vendimi. Kur, për nevoja të realizimit të projekteve të investimit, institucioni publik duhet të largohet nga prona ku kryen aktivitet, institucioni publik, me njoftimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare liron ambientet ku kryen veprimtarinë e tij, vetëm pasi Korporata e Investimeve Shqiptare, në bashkëpunim me institucione të tjera, publike apo subjekte private, i ka siguruar ambiente të përkohshme për vazhdimin e aktiviteteve të punës deri në marrjen në dorëzim të ambienteve të reja të ndërtuara.

10. Në funksion të zhvillimit të pronave, të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

11. Në listat e pronave, që i bashkëlidhen vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr. 820, datë 13.10.2010, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", të ndryshuar, dhe nr. 60, datë 1.2.2006, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror", të ndryshuar, të hiqen pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektorati i Përgjithshëm, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSSHSH), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB), Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat Minerare (AKSEM), Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKPMB), Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA), Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), Universiteti Politeknik i Tiranës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

SHTOJCA NR. 1
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

| Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e pasurisë ($m^2$) | Nga Sip. | | Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Truall ($m^2$) | Ndërtesë ($m^2$) | |
| 8240 | 4/184 | 9032.56 | 9032.56 | 2623.03 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural<br>VKM nr. 820 datë 13.10.2010, "Për |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", i ndryshuar |
| 8360 | 5/12 | 905 | 905 | 461 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural<br>VKM nr. 820 datë 13.10.2010, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", i ndryshuar |
| 8120 | 5/224 | 26410.02 | 26410.02 | 3199.87 | Shtet |
| 8120 | 5/225 | 19780.04 | 19780.04 | 3809.12 | Shtet |
| 8160 | 6/38 | 7107 | 7107 | 1411 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<br>VKM nr. 60, datë 1.2.2006, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi drejtorisë së përgjithshme të shërbimit social shtetëror", i ndryshuar |

## SHTOJCA NR.2
## Pronat me funksion publik për të cilat Korporata vepron si zhvillues

| Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e pasurisë (m²) | Nga Sip. | | Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Truall (m²) | Ndërtesë (m²) | |
| 8220 | 3/354 | 2902.6 | 2902.6 | - | Shtet |

## SHTOJCA NR.3

## Institucionet publike, të cilat lidhin marrëveshjen e bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Inspektorati i Përgjithshëm, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSSHSH), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), Universiteti Politeknik i Tiranës.

**VENDIM**
**Nr. 460, datë 31.7.2025**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 329, DATË 18.4.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË BILETAVE TË CIRKUT KOMBËTAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aneksi nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 329, datë 18.4.2013, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Cirku Kombëtar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

ANEKSI NR. 1
ÇMIMET E BILETAVE PËR CIRKUN KOMBËTAR

| Nr. | Kategoria e biletës | Çmimi |
|---|---|---|
| 1 | Repertor për fëmijë | 300 lekë |
| 2 | Repertor për të rriturit | 400 lekë |
| 3 | Premier* | 500 lekë |
| 4 | Mbrëmje Gala* | 1000 lekë |

**VENDIM**
**Nr. 461, datë 31.7.2025**

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Adela Demetja emërohet drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 465, datë 31.7.2025**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. REIDA KASHTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 15, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Reida Kashta, në masën 2 300 000 (dy milionë e treqind mijë) lekë.
2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të

Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 467, datë 31.7.2025**

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË KULLOTAVE DHE LIVADHEVE PËR KULLOTJE OSE KOSITJE, PËR VEPRIMTARI SHOQËRORE, SHËNDETËSORE, SPORTIVE E TURISTIKE DHE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË SË RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 15, dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozim e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit dhe për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike, si dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit janë sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike janë sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme janë sipas shtojcës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr. 632, datë 11.6.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

SHTOJCA NR. 1

*Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit*

| **Kullotje** | **Lloji i bagëtive** | **Tipi i kullotës** | |
|---|---|---|---|
| | | **Dimërore lekë/krerë/vit** | **Verore lekë/krerë/vit** |
| 1 | Dhen | 200 | 200 |
| 2 | Dhi | 250 | 250 |
| 3 | Gjedh | 1000 | 1000 |
| 4 | Njëthundrakë | 1200 | 1200 |
| **Kositje bari** | | **Dimërore lekë/m$^2$** | **Verore lekë/m$^2$** |
| | | | **2** |
| **Ndërtime** | | **Dimërore lekë/m$^2$/vit** | **Verore lekë m$^2$/vit** |
| 1 | Qendër stani e rrethuar | 100 | 100 |
| 2 | Qendër përpunim bulmeti | 150 | 150 |
| 3 | Ngrehinë banimi për barinjtë | 50 | 50 |
| 4 | Objekte ndihmëse për barinjtë | 150 | 150 |

SHTOJCA NR. 2

*Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike*

| Aktiviteti | Tarifa lekë/ha/vit | | |
|---|---|---|---|
| | **Për 1 vit** | **2–5 vjet** | **6–10 vjet** |
| Ndërtime agroturistike | 100 000 | 80 000 | 65 000 |
| Veprimtari sportive | 140 000 | 100 000 | 85 000 |
| Veprimtari çlodhëse dhe kampingje | 100 000 | 85 000 | 65 000 |

SHTOJCA NR. 3

*Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme*

| Aktiviteti | Sipërfaqja (ha) | Kohëzgjatja (vjet) | Tarifat (lekë/vit) |
|---|---|---|---|
| Park fotovoltaik | Deri në 10 | Deri në 10 | 192 000 |
| | | Mbi 10 | 173 000 |
| | Mbi 10 | Deri në 10 | 156 000 |
| | | Mbi 10 | 132 000 |
| Vendosje aerogjeneratorë | Deri në 10 | Deri në 10 | 120 000 |
| | | Mbi 10 | 100 000 |
| | Mbi 10 | Deri në 10 | 90 000 |
| | | Mbi 10 | 70 000 |

**VENDIM**
**Nr. 468, datë 31.7.2025**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 16, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2025 NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 16, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit për vitin 2025 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në paragrafin e parë, togfjalëshi “...gjithsej 1186...” zëvendësohet me “... gjithsej, 1196...”;

b) në shkronjën “a”, numri “5” bëhet “15”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 475, datë 31.7.2025**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 262, DATË 6.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË SPITALLË, DURRËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës", të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

| | Formati 61x86/8 |
|---|---|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/08/01 19:22:48 +02'00'
f69ffde9faaa430591a24baf62b9549f20250801192
23912031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*